

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“ Blerje Filma per Printer Fujifilm DI-HT Printer Fujifilm Drypix Lite”****REF - 58552-02-09-2023**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**32354100 – 0 “ Blerje Filma per Printer Fujifilm DI-HT Printer Fujifilm Drypix Lite”**

NR/R	Emertimi	Formati	Njesia	Sasia
1	Filma fujifilm DI-HT	35x43 cm	kuti X 100	<b>12</b>
2	Filma fujifilm DI-HT	20x25 cm	kuti X 100	<b>100</b>

VLERA E FONDIT LIMIT:

**Fondi limit: 1 ,920, 000 (nje million e nenteqind e njezet mije) leke pa tvsh.**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**a. Formularin e ofertes, Shtojca 1**

b. Lista e cmimeve te artikujve, shtojca 2

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

d. Sigurimin e Ofertës, Sipas vlerave te percaktuara ne Seksionin 3 te DST

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Operatori ekonomik duhet te kete si objekt te veprimtarise se tij "Tregtim te Paisjeve mjeksore".

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë 2(dy) viteve të fundit 2020, 2021. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara 2020, 2021 nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese **deshmi per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vleres se fondit limit te objektit te prokurimit te realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015**, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Deklaratë të ofertuesit mbi origjinën e mallit nga firma prodhuese.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga MSHMS për lejimin e tregtimit dhe instalimit të paisjeve Mjeksore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge, të markuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 **Filmat duhet të kenë afat skadence minimalisht 1 (një) vjetare. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë autodeklarate.**

2.3.8 **Afati i levrimit të mallit do të jetë: Malli do të dorëzohet në magazinën e Qendres Shendetesore Kamez brenda 30 (tridhjetë) dite pune nga data e lidhjes së kontratës. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë autodeklarate.**

2.3.9 **Filmat do të perdoren për Printer Fujifilm DI-HT Printer Fujifilm Drypix Lite**

2.3.10 **Operatori ekonomik duhet të paraqesin monstat e filmave.**

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.